



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:143737

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05747551

KA.nr.463/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Jahja Kerleshi” BI (DPH AMIQI) me NUI 811144542 dhe seli në rrugën “Ismail Qemali” në Gjakovë, kundër të paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 07.05.2023 në të cilën mungoi përfaqësuesi i paditësit ndërsa me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës së paditur, më 21 maj 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet kërkesëpadia e paditësit “Jahja Kerleshi” BI me NUI 811144542 kundër të paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, anulohet vendimi AUV.ref.04/02-2036/2020 i datës 01.10.202 i të paditurit dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te i padituri, ashtu që ai në afat prej tridhjetë (30) ditëve në ri procedurë të nxjerrë akti të ri administrativ sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe t’ia dërgoj paditësit si palë ankuese.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 28.10.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit AUV Ref. 04/02-2036/2020 të datës 01.10.2020 të së Paditurit.
2. Ai në padi ka pretenduar se i Padituri në arsyetimin e vendimi e goditur me të cilin e ka refuzuar ankesën kundër vendimit të inspektorëve sanitar, nuk i ka specifikuar arsyet për refuzimin e ankesës si dhe për dënimin prej 200 euro. Sipas tij, renditja e tavolinave në momentin e inspektimit dhe distanca mes tyre ka qenë në pajtim me vendimin e Qeverisë për masat parandaluese për përhapjen e COVID 19 të datës 27.07.2020. Ka

theksuar se në vendimin e kundërshtuar nuk ka asnjë provë, përveç pretendimit se tavolinat nuk kanë pasuar distancën e duhur në mes vete.

3. I padituri në përgjigje e tij në padi dhe gjatë gjithë procedurës si dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj atë si të pabazuar. Ai ka deklaruar se më datë 21.09.2020 në ora 22:10 minuta D.P.H. “Amiq” është gjobitur në shumë prej 500€, pasi nuk ka respektuar vendimin nr. 01/17 të datës 08.07.2020 të lëshuar nga qeveria e Republikës së Kosovës, ndërsa ndaj kësaj gjobë të shqiptuar Paditësi kishte parashtruar ankesë më datë 25.08.2020. Sipas tij, Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë më datë 01.10.2020 kishte nxjerr vendim AUV Ref. 04/02-2036/2020 të datës 01.10.2020 duke e refuzuar ankesën e palës tani Paditësit. Përfundimisht ka deklaruar se vendimet e atakuara janë profesionale dhe të marra konform dispozitave ligjore në fuqi.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

4. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: ankesa/kundërshtimi i paditësit kundër fletëparaqitjes me numër 000328 të datës 21.08.2020, e protokolluar në komunën e Gjakovës më datë 25.08.2020 dhe vendimi me nr. AUV.ref.04/02-2036/2020 i datës 01.10.2020
5. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
6. Inspektorati Sanitar më datë 21.08.2020 ka gjobitur Paditësin në shumë prej 500euro, me arsyetim se në hapësirat e lokalit DPH AMIQI, pra te Paditësi, nuk janë respektuar masat Anti-Covid 19 të përcaktuara me vendimin e qeverisë, gjegjësisht nuk e ka respektuar distancën mes tavolinave.
4. Paditësi më datë 03.11.2020 ndaj fletëparaqitjes ka parashtruar ankesë, ndërsa në lidhje me ankesën Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave ka marr vendim AUV.Ref.04/-2296/2020 të datës 24.11.2020, duke e refuzuar ankesën. Me këtë vendim, i Padituri gjithashtu e kishte ulur gjobën nga 500€ në 200€.

III. Vlerësimi meritor i rastit

5. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Padiësisë është e bazuar në ligj.
4. Gjykata vlerësoi se i Padiësi e ka zbatuar procedurën administrative në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat procedurale të paraparë me ligjet e veçanta, të cekur në këtë aktgjykim.
5. Megjithatë, gjykata gjeti se vendimi i goditur është hartuar në kundërshtim me nenin 47 para. 1 nënpara. 1 të LPPA-së, sipas të cilit “*Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes*”. Në pjesën hyrëse të vendimit të goditur nuk figuron emri i asnjërit nga anëtarët e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, si dhe në të është nënshkruar vetëm udhëheqësi i Inspektoratit Sanitar të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.
6. Në anën tjetër, nenit 60 i Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (këtu e tutje LK) e rregullon organin për vendosje sipas kundërshtimit të palës ndaj sanksionit kundërvajtës, i cili në para. 1 ka rregulluar se “*Në rast se pala parashtron kundërshtimin ndaj sanksionit kundërvajtës, procedura zhvillohet pranë organit të kundërvajtjes nga komisioni për vendosje, në përbërje prej së paku tre (3) anëtarëve. Parashtrimi i kundërshtimit duhet të bëhet brenda tetë (8) ditëve dhe i njëjti shtyn ekzekutimin për pagimin e gjobës në pajtim me dispozitat e këtij ligji*”, ndërsa në para. 2 ka përcaktuar se “*Anëtarët e komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni janë personat zyrtarë të autorizuar me shkallën përkatëse të përgatitjes profesionale dhe përvojës së punës të nevojshme, nga të cilët së paku një nga anëtarët të jetë jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës*”. Siç vërehet, me këtë dispozitë ligjore kërkohet që organi që vendos për kundërshtimin në radhët e tij të ketë një jurist të diplomuar, i cili e ka të kryer provimin e jurisprudencës.
7. Në rastin konkret, nga mënyra se si është përpiluar vendimi i goditur nuk mund të kuptohet cila ka qenë përbërja e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave dhe se ai komision në radhët e tij e ka pasur anëtarë plotësojnë kushtet nga neni 60 para. 2 i LK-së. Si i tillë, është i paligjshëm në kuptim të nenit 48 para. 2 lidhur me nenin 52 para. 1

nënpara. 1.4 të LPPA-së, sipas të cilit “*Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: (...) 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ*”.

8. Gjykata rikujton se, ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë, siç parasheh neni 44 para. 1 i LKA-së, ndërsa për nulitetin (paligjshmërinë) e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, siç urdhëron neni 44 para. 2 i LKA. Kjo nënkupton se, gjykata e shqyrton ligjshmërinë e aktit administrativ të goditur edhe për arsye të cilat paditësi nuk i nga ngritur para gjykatës.
9. Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se për shkak të metave të cekura më lartë e pati juridikisht të pamundshme që t’i vlerësoj pretendimet e Paditësit për gjendjen faktike, rrjedhimisht nuk ishte e mundshme as vendosja me juridiksion të plotë në kuptim të nenin 43 para. 3 të LKA-së.
10. Për këto arsye, gjykata e anuloi aktin administrativ nr. vendimit AUV.Ref.04/-2296/2020 të datës 24.11.2020 të së Paditurit dhe meqenëse karakterit i çështjes konkrete është i tillë që duhet që në vend të aktit të anuluar administrativ të nxirret një tjetër, atëherë gjykata e obligoi të Paditurin si organ administrativ i shkallës së dytë që jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e dërgimit të këtij aktgjykimit ta nxjerr aktin e ri administrativ sipas udhëzimeve të kësaj gjykate dhe t’ia dërgoj Paditësit si palë ankuese.

IV. Udhëzimet për organin administrativ në ri procedurë.

11. Në ri procedurë Agjencia për Ushqim dhe Veterinari duhet të formoj komision sipas nenit 60 para. 2 të LK-së, i cili duhet të rivlerësoj ankesën e Paditësit dhe të nxjerrë akt administrativ të ri në përputhje me dispozitat LPPA-së, veçanërisht nenit 47 dhe 48 të LPPA-së, si dhe t’ia dërgoj Paditësit. Konkretisht, i Padituri me rastin e hartimit të aktit të tij administrativ të ri duhet të cek me emër dhe mbiemër secilin anëtarë të komisionit dhe të tregoj cili nga ata është jurist i diplomuar me provim të kryer të jurisprudencës, ndërsa vendimin duhet ta nënshkruar kryetari i komisionit si organ kolegjal dhe procesmbajtësi, siç përcakton neni 47 para. 2 i LPPA-së.
12. Gjykata rikujton se i Padituri me rastin e nxjerrjes së aktit të ri administrativ është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me

procedurën, siç e ka paraparë neni 65 i LKA-së. Gjykata sidomos rikujton se nxjerrja e vendimit të ri në kundërshtim me vërejtjet e gjykatës është bazë për fillimin e konfliktit administrativ sipas nenit 16 para. 1 nënpara. 5 i LKA-së.

13. Përveç kësaj, gjykata e sheh të arsyeshme që mënyrë të veçantë të sqaroj se akti administrativ i ri në asnjë rrethanë nuk mundet do të përkeqësoj situatën juridike në dëm të Paditësit. Kjo nënkupton se, i Padituri në ri procedurë administrative nuk mund të nxjerr akt administrativ, i cili është më i disfavorshëm se akti administrativ i anuluar në këtë procedurë të konflikti administrativ.
14. Duke u bazuar në nenet 13 para. 1 nën para. 1.12 lidhur me para. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, nenin 46 të LKA-së, nenin 64 Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.463/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.